

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	07.01.2021	Kërkesë për informacion	10.01.2022	<p>1- Ju dispononi një Leje Drejtimi Italiane, të konvertuar nga një Leje Drejtimi Shqiptare, lëshuar nga një vend anetar i BE. Për transferimin e saj në leje drejtimi Gjermane Ju duhet të drejtoheni në Drejtorinë e Transportit Gjerman në qytetin ku jetoni dhe të kërkontë informacionin e konvertimit të Leje Drejtimit Italiane në Leje Drejtimi Gjermane, apo mund të qarkulloni me të në Gjermani mbasi është një Leje Drejtimi e lëshuar nga një shtet anetar i BE-së sikurse dhe Italia.</p> <p>2- Nga ana e DPSHTRR -së, mund të përcillet në vijim të kërkesës së palës Gjermane nëpërmjet komunikimit me email, nëse do të kërkohej prej tyre, një informacion mbi kategoritë përkatëse të Leje Drejtimit Shqiptare dhe datat e lëshimit të tyre.</p>	E plotë	0
2	07.01.2022	Kërkesë për informacion	07.01.2022	<p>Për të bërë çregjistrimin e përkohshëm, përhershëm ose heqje e përhershme nga qarkullimi në Shqipëri për t'u eksportuar në shtete të tjera te mjetit tuaj, duhet të dini se:</p> <p style="text-align: center;">https://www.dpshttr.al/mjete/cregjistrimi-i-mjetit</p> <p>JU duhet të paraqiteni vetëm me targat e mjetit që do çregjistroheni (pra, pa mjetin) në Drejtorinë Rajonale ku keni vendbanimin në rastin tuaj pranë DRSHTRR Durrës.</p> <p>Për me shume informacion rreth DPSHTRR: https://www.dpshttr.al/</p> <p style="text-align: center;">Faleminderit,</p>	E plotë	0
3	13.01.2022	Kërkesë për informacion	17.03.2022	<p>Në lidhje me regjistrimin e mjeteve të kategorive N1 dhe M2, veprimet e regjistrimit për këto mjete duhet të jenë të bazuara në VKM Nr. 633, datë 26.10.2018 "Për masat kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorike dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje pozitive dhe nga ato me ndezje me kompresion që djegin gaz natyror apo të lëngshëm për përdorim në automjete", i ndryshuar. Në përjeket e Drejtorisë së Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugorv - DPSHTRR dhe Ministrisë e Infrastrukturas dhe Energjisë - MIE për shqyrtimin e rastit tuaj për të gjetur hapësira ligjore për regjistrimin e mjeteve për raste të veçanta, siç ishte dhe rasti juaj, VKM Nr. 633 nuk lejonte hapësirat e tilla.</p> <p>Si rezultat, mjeti juaj nuk i përmbush kushtet e regjistrimit, referuar kësaj VKM.</p>	E plote	0
4	18.01.2022	Kërkesë për informacion	19.01.2022	<p>Ju informojmë se lejohet regjistrimi i automjetit për tu pajisur me targa Shqiptare për një shtetas të huaj duke plotësuar kushtet si më poshtë:</p> <p>Kur zotëruet i mjetit, është shtetas i huaj, rezidentë në Republikën e Shqipërisë, kërkohet lejeqendrimi, e lëshuar nga organet kompetente të Ministrisë së Brendshme, e vlefshme; Veç lejeqendrimit, të vlefshme, dokumentet e nevojshëm për regjistrimin e mjetit janë:</p> <p style="padding-left: 20px;">dokumenti identifikues;</p> <p style="padding-left: 20px;">dokumentin e fitimit të pronësisë së mjetit;</p> <p style="padding-left: 20px;">dokumentin e identifikimit të treguesve të mjetit, që bëhet nga specialistët e DRSHTRR-së;</p> <p>dokumentet shoqërues me treguesit teknik dhe të pronësisë së mjetit, të lëshuar nga organet zyrtare të shtetit nga vjen mjeti si leje qarkullimi dhe/ose certifikatë pronësie, ose çregjistrim për eksport në original;</p> <p style="padding-left: 20px;">dokumentin që konfirmon kryerjen e procedurave doganore;</p> <p>kontratën e sigurimit të mjetit sipas kushteve të marrëveshjes së përbashkët DPSHTRR-AMF;</p> <p>për rastet kur mjeti është i blerë në Shqipëri kërkohet konfirmimi nga Regjistri Barrëve Siguroese, sipas kushteve të marrëveshjes së përbashkët DPSHTRR-RBS.</p> <p>Gjithashtu mjeti duhet të plotësojë edhe kriteret për kategorinë mjedisore, në zbatim të VKM Nr. 633, datë 26.10.2018, e ndryshuar.</p>	E plote	0

5	18.01.2022	Kërkesë për informacion - Cila është procedura e kontrollit teknik të zhurmatve nga mjetet e transportit? A shoqërohen mjetet e reja me një certifikatë për zhurmat para se të hyjnë në tregun shqiptar? A ka ndonjë rregullore apo udhëzim apo akt tjetër lidhur përsa më sipër? Nëse po, ju lutemi na vini në dispozicion kopje të këtyre akteve.	31.01.2022	Në vijim të kërkesës Tuaj të ardhur me email, në përputhje me nenin 11 të ligjit Nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor ju bëjnë me dije se: Për pikat 1 dhe 3; "Procedura e kontrollit teknik të zhurmatve nga mjetet e transportit bazohet në Udhëzimin Nr.6, dt. 12.11.2021 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, përafuar plotësisht me Direktivën 2014/45/BE, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 3 prill 2014 "Mbi kontrollin teknik periodik të automjeteve dhe rimorkiove të tyre, dhe që shfuqizon Direktivën 2009/40/KE". Numri CELEX 32009L0103, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, numër 127, datë 29.04.2014, faqe 51 – 128". Pika 2; Mjetet e reja shoqërohen me certifikatë konformiteti (CoC), të lëshuar nga prodhuesi ku në pikën 46 të kësaj certifikate përcaktohet niveli i zhurms që prodhon mjeti kur ai është i ndaluar dhe në lëvizje. Faleminderit,	E plotë	0
6	21.01.2022	Kërkesë për informacion	27.01.2022	Në përgjigje të e-mailit Tuaj, në zbatim të ligjit Nr. 119/2014 "Për të drejtën e Informimit" dhe ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", ju bëjmë me dije se është miratuar me VKM Nr.39 datë 19.01.2022, "Marreveshja Ndryshuese ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, mbi njohjen e ndërsjelle të Lejeve të Drejtimit me qëllim konvertimi, miratuar me Vendimin Nr. 209, datë 29.03.2021, të Këshillit të Ministrave" për konvertimin e lejeve të drejtimit me Italinë dhe shumë shpejt do të fillojë implementimi i saj, mbi bazë dhe të ndryshimeve të kërkuara nga ana e palës italiane në marreveshjen e datës miratuar me VKM Nr. 209, datë 29.03.2021.	E deleguar	0
7	21.01.2022	Kërkesë për informacion	04.02.2022	Shkrese Nr. Prot 1592/1 Date 04.02.2022	E plotë	0
8	27.01.2022	Kërkesë për informacion - Mbi një kronike mbi makinat në qarkullim	01.02.2022	www.dpshttr.al/sherbime-online/open-data-statistika-raporte	E plotë	0
9	01.02.2022	Kërkesë për informacion	02.02.2022	Në zbatim të pikës 3, të nenit 4 të ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar, Udhëzimit të MF nr 26, datë 4.09.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar, parashikohet: "Taksa vjetore e mjeteve të përdorura është e vlefshme për 365 ditë. Detyrimi i taksës paguhet për vitin kalendarik (nga 1 janari deri më 31 dhjetor) për të cilin ka lindur detyrimi. Taksa e paguar në vitin aktual, pavarësisht nga momenti në të cilin ajo paguhet, ka vlefshmëri 365 ditë. Pronari i mjetit, i cili nuk kryen pagesën e kësaj takse brenda 10 ditëve nga mbarimi i afatit të vlefshmërisë së parashikuar, detyrohet të paguajë një gjobë prej 0.06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë vonesë nga dita e fundit e vlefshmërisë. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike". Referuar kontrollit në sistemin informatik edpshttr, për mjetin me targë AA03900, ka kryer pagesën e Taksës Vjetore të Mjeteve të Përdorura për vitin 2020, me datë 30.12.2020, me afat vlefshmërie 365 ditë. Afati i vlefshmërisë deri me datë 30.12.2021. Taksa i përket vitit kalendarik (nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2020) por me afat vlefshmërie deri me datë 23.12.2021. Për sa më sipër, mjeti me targë AA03900, ka qenë i pajisur me taksë të vitit 2020 (e cila lehtësisht vërtetohet nga viti i cili është i shënuar në pullën e taksës), por me afat vlefshmërie deri me datë 30.12.2021. Si rrjedhojë, për vitin 2021, mjeti me targë AA03900, nuk ka paguar Taksën Vjetore të Mjeteve të Përdorura dhe nuk ka qenë i pajisur me pullë takse të vitit 2021. Taksa e paguar me datë 01.02.2022, i përket vitit kalendarik 1 janar-31 dhjetor të vitit 2021. Për vitin 2022, ju rezultoni pa Taksë Vjetore të Mjeteve të Përdorura.	E plotë	0

10	02.02.2022	informacion lidhur me invest	15.02.2022	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor është institucion që ofron shërbime ndaj subjekteve fizike dhe juridike, shtetërore dhe private, në veprimtarinë e transportit rrugor.</p> <p>DPSHTRR cilësuar nga VKM nr.343, datë 21.07.1999 "Per Krijimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor", pika 3 si institucion me vetëfinancim, nuk konsumon as edhe një të ardhur nga buxheti i shtetit.</p> <p>Përdorimi i të ardhurave të realizuara nga DPSHTRR destinohet si parashikohet në kodin rrugor neni 223 i tij:</p> <p>Aktet rregulluese për problemet financiare që lindin për zbatimin e urdhrave që përmbahen në normat e këtij Kodi (ndryshuar shkronja "b" e pikës 2 me ligjin nr. 63/2021, datë 7.5.2021)</p> <p>1. Ministria që mbulon veprimtarinë përkatëse të përcaktojë tarifat për kryerjen e shërbimeve që lidhen me zbatimin e kompetencave në fushën e motorizimit civil. Veprimtaria financiare e organeve përkatëse të ministrisë që mbulon veprimtarinë përkatëse është me vetëfinancim.</p> <p>2. Vlerat që lidhen me të drejtat për operacione teknike dhe tekniko-administrative në kompetencë të këtij organi, destinohen për shpenzimet e mëposhtme:</p> <p>a) për blerjen e pajisjeve teknike të nevojshme për shërbimet, si dhe për funksionimin dhe mirëmbajtjen e këtyre pajisjeve;</p> <p>b) për kryerjen apo nxitjen e pjesëmarrjes në kurse të kualifikimit, azhurnimit ose të specializimit pasuniversitar të personelit në lidhje me zbatimin e këtij Kodi, si dhe për zhvillimin e programeve të sigurisë rrugore;</p> <p>c) për operacione të ndryshme që kanë të bëjnë me investime, kolaudime, homologime, vrojtme, furnizime me materiale e tabela të ndryshme, të nevojshme për kryerjen e të gjitha shërbimeve në kompetencë të këtij organi, për magazinime, shpërndarje dhe dërgime të materialeve dhe tabelave të mësipërme.</p> <p>Ridimensionimi i infrastrukturës, rikualifikimi i produkteve të shërbimeve tredimensionalisht: në sasi, në kosto e cilësi dhe nxitja, promovimi dhe motivimi i asetit më të çmuar - kapacitetit human janë fokusi i rikonceptimit të ofrimit të shërbimit nga DPSHTRR.</p> <p>Në tre vitet e fundit të dhënat empirike të realizimit të të ardhurave flasin për rritje galopante të tyre ndërkohë që tarifat e shërbimeve janë reduktuar ndjeshëm. Tarifë e reduktuar është edhe ajo e kolaudimit që është përgjysmuar për qytetarët në krahasim me konçesionarin.</p> <p>Rimarrja e këtij shërbimi i ofroi arkës së DPSHTRR rreth 419 milion lekë në periudhën Qershor-Dhjetor 2021, para këto që po i kthehen qytetarit.</p> <p>Strukturat e reja janë parashikuar multifunksionale për një seri shërbimesh që do shtohen duke realizuar në kompleks 1,295 shërbime në një orë.</p> <p>Këtu ndalojmë për të bërë sqarimet e nevojshme në lidhje me transferimin e shërbimit të Dpshttr:</p> <p>Në media flitet për investime që perceptohet se janë bërë mbi objektin e konçesionit dhe pikërisht këtu fillon konfuzioni për publikun.</p> <p>Investimet po bëhen në QKT-të ekzistuese, pronë e DPSHTRR-së që konçesionarit ju dhanë në përdorim të ushtrimit të aktivitetit falas dhe jo mbi infrastrukturën e investuar nga SGS.</p> <p>Shuma që po investohet nuk është kosto plus që po i merret qytetarit, por është një tarifë e përgjysmuar nga ajo që i paguante SGS-së e cila nuk shkon jashtë por ri-investohet në projekte avangardë të cilat synojnë të rrisin në tërësi performancën e Institucionit, në raport me shërbimet e ofruara ndaj qytetarit, shërbime të cilat domosdoshmërisht duhet të ecin me hapin e kohës, teknologjisë si dhe duhet të plotësojnë standartet më të larta duke marrë për referencë edhe institucionet homologe europiane. Investohet në zgjidhje inovative që synojnë përmirësimin e aksesit në shërbime, rritjen e efikasitetit, transparencës dhe uljen e barrës burokratike për qytetarin, duke e bërë këtë të fundit partnerin tonë më të rëndësishëm.</p> <p>Për informacionin e servitur më poshtë kërkojmë vëmendje të shtuar për mos konfondimin e konceptit riinvestim me investim. Mbi QKT-të ekzistuese të dorëzuara në vitin 2009 sipas "Planit të veprimt" të urdhëruar nga Ministri me shkresën me nr. Prot 4689 datë 05.08.2009, nga SGS nuk është kryer as edhe një investim, pasi edhe në kontratë nuk është parashikuar një gjë e tillë.</p> <p>Terminologjia e përdorur është rehabilitim, e pa kuantuar në vlerë. Fakt është që mbi to nuk është kryer as edhe një investim, përveç shërbimeve të mirëmbajtjes, të cilat lenë për të dëshiruar.</p> <p>Investimet në process nga DPSHTRR konsistojnë në rikualifikimin e 55,850 m2 ambiente funksionale dhe rikonstrukcion rrënjësor të 11,720 m2 godinash, mbi të cilat ndërhyrjet e vetme të parashikuara në kontratën konçesionare kanë qenë për shpenzime mirëmbajtjeje. (Sqarim: shpenzimi nuk është investim) Investimi i vetëm objekt i konçesionit është ndërtimi i QKT-së së re në Prezë dhe linjat e testimit, edhe këto investime të amortizuara prej 11 vitesh.</p> <p>Lekët e investuara nga SGS, nuk janë për QKT-të ekzistuese (të vitit 2009).</p> <p>Për të vërtetuar sa më lartë ju vëmë në dispozicion një pjesë ekstrakt të kontratës konçesionare.</p> <p>Për transparencë i referohemi dy problematikave gangrenë:</p> <p>-nevojave reale për investim, dhe</p> <p>-kosto-efektivitetit të investimit.</p> <p>Nga sa sqaruar më lartë, godinat ekzistuese që shteti ja dha në "gëzim të qetë" (terminologji e përdorur në kontratë për dhënien e ambienteve shtetërore pa as edhe një benefit) konçesionarit janë rikthyer në gjendje të mjerueshme dhe autoriteti ka qenë i detyruar t'i merrte në dorëzim "duke marrë parasysh vjetërsinë dhe amortizimin e arsyeshem" terminologji edhe kjo e përdorur në nenin 3.7 të kontratës konçesionare.</p> <p>(Sqarojmë se godinat që i janë dorëzuar SGS kanë qenë ndërtime ekzistuese të periudhës së Monizmit të rikonstruktuara pikërisht</p>	0
----	------------	------------------------------	------------	---	---

11	08.02.2022	Kërkesë për informacion	<p>Projektet edukative mbi sigurinë rrugore mund t'i gjeni edhe në këtë link: https://www.dpshttr.al/te-reja/botime/projektet-edukative-mbi-sigurine-rrugore</p> <p>Prej kohësh, alarmi global nga shifrat e larta të fataliteteve nga aksidentet rrugore ka nxitur hartimin dhe ekzekutimin e politikave të ndryshme për parandalimin e tyre, si edhe mbështetur nisma për edukimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit të njerëzve mbi sigurinë rrugore, si një përpjekje e përbashkët e institucioneve shtetërore, organizatave kombëtare e ndërkombëtare, subjekteve e deri të përdoruesit e rrugës për të garantuar rrugë më të sigurt.</p> <p>Hartimi dhe zbatimi i një plani strategjik i cili i përgjigjet thirrjes urgjente për parandalimin e aksidenteve, DPSHTRR iu përgjigj përmes aktiviteteve dhe nismave si në vijim;</p> <p style="text-align: center;">Këndi Edukativ i Sigurisë Rrugore</p> <p>Këndi Edukativ i Sigurisë Rrugore është kthyer tashmë një orë edukative e përvajshme në shumë qytete të Shqipërisë, ku DPSHTRR në bashkëpunim me mësuesit, shkollat dhe bashkitë e ndryshme improvizojnë rrugën me të gjithë elementët e saj, si dhe zhvillojnë orë aktive mbi sigurinë rrugore.</p> <p>Deri më tani, janë zhvilluar 70 evente edukative në 14 qytete të Shqipërisë, ku kanë marrë pjesë rreth 5000 fëmijë.</p> <p>Programi i Sigurisë Rrugore përgjatë vitit 2021 shënoi një numër të madh aktivitësh, trajnimesh, broshurash edukative dhe intensifikim të përpjekjeve për të bërë të mundur që Edukimi mbi Sigurinë Rrugore të përfshihej sa më shumë në shkollat e Republikës.</p> <p>Në Janar të vitit 2022, këto përpjekje u finalizuan me marrëveshjen midis Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar ku palët kanë vendosur që me kalendarin e tyre të përbashkët të përfshihen të gjitha shkollat e arsimit parauniversitar, tek të cilat zhvillohet Këndi i Sigurisë i ndarë në dy pjesë, e para ora edukative në klasë me broshurat tona, për të vijuar më tej me trajnimin në pistë. Këto aktivitete do të bëhen duke alternuar dhe ndihmën e parë nga Kryqi i Kuq.</p> <p>Aktualisht në kalendar janë 304 institucione arsimore të cilat do të përfshihen në këtë projekt.</p> <p style="text-align: center;">Programi i Simulimit të Testimit Online</p> <p>Një aspekt tjetër i rëndësishëm në fokusin e DPSHTRR, është Programi i Simulimit të Testimit Online i cili prezantohet në formën web-app i përshtatshëm për versionin desktop gjatë përdorimit në kompjuter dhe gjithashtu i shkarkueshëm si aplikacion për lehtësi përdorimi në celular. Ky program është një pikë e rëndësishme që do të ndikojë ndjeshëm në përgatitjen më mirë të kursantëve të cilët regjistrohen pranë këtij institucioni për t'u pajisur me Leje Drejtimi të kategorive të ndryshme. Simulimi i Testimit Teorik ka për qëllim orientimin e kursantëve, jo vetëm me praktikimin online të testet teorike zyrtare të miratuara nga DPSHTRR, por edhe me çdo informacion, programin përkatës të përgatitjes teorike apo çdo pyetje/përgjigje që ata kanë rreth procesit.</p> <p>Simulimi i Testimit Teorik online është ndërtuar në mënyrë të tillë që ndihmon kursantin në çdo nivel përgatitje duke ruajtur statistika dhe të dhëna mbi ecurinë e tij.</p> <p>Në periudhën Janar 2019-Janar 2022, janë realizuar 485,300 simulime të Testit Teorik Online duke i ndihmuar kandidatët të familjarizohen me Testin e të provojnë veten online.</p> <p style="text-align: center;">Manuali Zyrtar i Teorisë</p> <p>Një nga risitë kryesore në aspektin e sigurisë rrugore, është botimi i manualit të parë zyrtar të përgatitjes për pajisjen me Leje Drejtimi të kategorive A1, A2, A, B1, B dhe BE. Materiali është përgatitur nga ekspertët e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, duke u bazuar në parimet e Kodit Rrugor dhe në metodat më të reja të aftësimit mbi rregullat e qarkullimit. Ai do të shërbejë si tekst teorik për formimin e kandidatëve për pajisjen me Leje Drejtimi.</p> <p>Qëllimi kryesor i këtij teksti është promovimi i sigurisë në rrugë, i shembujve të mirë në drejtimin e mjetit dhe i mirësjelljes e mirëkuptimit gjatë përdorimit të rrugës, duke ndjekur me përpikmëri udhëzimet e Ligjit. Njohja e rregullave të qarkullimit, aftësitë e mira në drejtimin e mjetit dhe përkujdesja ndaj përdoruesve të tjerë të rrugës, rrisin në mënyrë të ndjeshme efektin e rregullave të sigurisë në rrugë. Sa më shumë efekt të kenë këto rregulla, aq më i lartë është ndikimi pozitiv në jetën e gjithsecilit. Në këtë kontekst, ky material edukativ konsiderohet si një interpretim i Kodit Rrugor nga pikëpamja e sigurisë rrugore. Manuali përveçse është i publikuar online, do të botohet për t'u shpërndarë për të gjithë sektorin, autoshkollat, instruktorët dhe kursantët! Ky botim i jep fund përdorimit të materialeve të pacertifikuara dhe përdorimit të koncepteve të vjetruara për edukimin mbi rregullat e qarkullimit rrugor. Librat mësimorë dhe manualet profesionale të testimit certifikohen nga shteti dhe janë informacion i hapur, i njehsuar për publikun dhe në dispozicion të çdo nxënësi. Linku si më poshtë:</p> <p style="text-align: center;">https://www.dpshttr.al/te-reja/botime/programi-i-pergatitjes-teorike-leje-drejtimet-e-kategorive-a1-a2-b1-be</p> <p style="text-align: center;">Pit Stop Edukativ</p> <p>Pit Stop-i Edukativ vjen si një nismë e re nga DPSHTRR për vitin 2022, në kuadër të edukimit dhe rifreskimit të rregullave të sigurisë rrugore. Të gjithë drejtuesit e mjeteve që kanë kryer tre kundërvajtje të rënda gjatë vitit të fundit dhe konsiderohen si kontingjent përsëritës nga sistemi i Policisë Rrugore, në fazën e rinovimit të Lejes së Drejtimit do t'i nënshtrohen një testi teorik për verifikimin e njohurisë mbi normat e sjelljes në rrugë dhe rregullat</p>	0
----	------------	-------------------------	--	---

12	09.02.2022	Kërkesë për informacion	09.02.2022	https://www.dpshttrr.al/mjete/taksa-detyrime	E plote	0
13	12.02.2022	Kërkesë për informacion	14.02.2022	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor - DPSHTRR është institucion zbatues i ndryshimeve në Kodin Rrugor.</p> <p>Referuar "Nenit 242/a" Qarkullimi Provë, Neni 97 i Kodit Rrugor, specifikon se:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Mjetet rrugore, që qarkullojnë për arsye demonstrimi, shitjeje e kontrolli teknik, duhet të qarkullojnë brenda territorit administrativ të bashkisë, ku ka vendodhjen personi juridik ose fizik, tregtar dhe nuk lejohet kalimi nga një territor tjetër administrativ. 2. Përfshirë, mjeti lejohet të qarkullojë me targë "prove" dhe të kalojë në një territor tjetër administrativ, të ndryshëm nga ai i selisë së personit juridik ose fizik, tregtar, kur për shkak të një veprimi juridik, mjetit do t'i ndryshohet pronësia. 4. Mjeti i pajisur me targë prove ka të drejtë të qarkullojë nga ora 07:00 - 18:00. <p>Për me shume informacion mund ti drejtoheni organeve kompetente.</p> <p>Faleminderit,</p>	E plotë	0
14	14.02.2022	Kërkesë për informacion	22.02.2022	<p>Sa janë detyrimet tatimore të papaguara (borxhi), që kanë drejtuesit e automjeteve në Republikën e Shqipërisë kundrejt Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve?</p> <p>Vlera e Taksës vjetore për mjetet e përdorura (TVMP) llogaritet mbi disa indikatorë të mjetit si, viti i prodhimit, lënda djegëse dhe fuqia motorike. Për këtë arsye dhe sepse vlera e kamatvonesës për TVMP e prapambetura llogaritet ditore, vlera e detyrimit tatimor të papaguar nga drejtuesit e automjeteve në Republikën e Shqipërisë kundrejt Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve është subjekt ndryshimi ditore dhe e vëzhgim për tu llogaritur në total për të gjitha mjetet.</p> <p>2. Si është parashikuar mbledhja e debisë së këtyre shtetasve që kanë në përdorim automjetin, me taksat e papaguara?</p> <p>Mbi mbledhjen e debisë, Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor (DPSHTRR) lajmëron në mënyrë shkresore periodike pronarin e mjetit dhe informon mbi listën e mjeteve debitorë Policinë Rrugore Rajonale, Drejtorinë Tatimore Rajonale dhe Bashkinë përkatëse. Gjithashtu bllokoi marrjen e çdo lloj shërbimi për një mjet debitor. Mbështetur edhe në këto masa vetëm në vitin 2021 DPSHTRR, krahasuar me një vit më parë, ka ulur numrin e debitorëve historikë me -13.5%.</p> <p>3. Sa është numri i automjeteve në qarkullim që janë debitorë?</p> <p>Numri i automjeteve debitorë është 152,267 (ose 20.5%) automjete nga 741,425 automjete të regjistruara ose të çregjistruara përkohësisht.</p> <p>4. Për sa prej tyre keni dërguar pranë institucioneve përkatëse (Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor Shqiptar, Policia Rrugore) bllokimin e automjetit për shtetasit që i kanë në pronësi?</p> <p>DPSHTRR dhe Drejtorinë Rajonale njoftojnë në mënyrë periodike brenda vitit institucionet rajonale të Drejtorisë Tatimore, Drejtorisë Policisë Vendore dhe Bashkitë përkatëse duke i vënë në dispozicionë listën e automjeteve debitorë dhe periudhën për të cilën janë debitorë.</p>	E plotë	0

15	17.02.2022	Kërkesë për informacion	17.02.2022	<p>DPSHTRR ju falenderon dhe ju konsideron ju bashkëpunëtorët më të mirë për ndërmarrjen e vendimeve të drejta në zbatim të interesit publik dhe përmirësimit të shërbimeve për qytetarët duke konsideruar dëgjimin e kërkesave dhe ankesave tuaja, si pjesë të rëndësishme të politikave të institucionit tonë. Rinvestimet e reja dhe procesi i digjitalizimit janë pjesë e zhvillimeve për të lehtësuar shërbimet e dhëna nga DPSHTRR, ashtu si dhe kërkesa juaj. Mënyrë më të shpejtë të rinovimit të lejeve të drejtimit si nje dokument identifikimi mund te behet vetem me paraqitjen e personit fizik bazuar ne:</p> <p>1-Autoriteti lëshues i lejedrejtitimit në Republikën e Shqipërisë është Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), e cila është në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE).</p> <p>2- Baza Ligjore mbi të cilën mbështetet lëshimi i Leje Drejtimit është Udhëzimi i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës Nr. 241/3, datë 19.02.2016 "Mbi karakteristikat e materialit, elementët e sigurisë, elementët grafikë dhe mënyra e plotësimit të lejedrejtitimit të ri të mjeteve rrugore";</p> <p>3 -Rinovimi i lejedrejtitimit bëhet mbi bazën e Certifikatës Mjekësore pas kryerjes së ekzaminimit të aftësive psiko-fizike për të drejtuar mjete me motor. Udhëzimi i sipërcituar ka përcaktuar se Leje Drejtimit lëshohet në Degët e Drejtuesve të Mjeteve të Drejtorive Rajonale në plotësim të çdo specifikë të dhëna në të si dhe duke plotësuar dhe dy elemente sigurie që janë Fotografia Digjitale dhe firma digjitale nga qytetari në aplikim për pajisje me Leje Drejtimit. Këto dy elemente sigurie për momentin nuk mund të arrihen nëpërmjet portalit e-albania.</p> <p>4 -Rinovimi i Leje Drejtimit është një shërbim që i ofrohet zotëruesit të lejedrejtitimit në sportelet e shërbimit të Drejtorive Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe për vet specifikat që ka ky shërbim, nuk mund të ofrohet nëpërmjet portalit e-albania .</p> <p>Në lehtësimet e mundësuar nga DPSHTRR në Tiranë, leja e drejtimit tërhiqet në zyrat e shërbimit të ish-NSHRAK, leja e drejtimit tërhiqet brenda 30 minutash. Në drejtoritë e tjera kjo procedurë është lehtësuar në 3-5 ditë pune. Për më shumë informacion: https://www.dpshttr.al/leje-drejtimi/rinovim-i-lejes-se-drejtitimit</p> <p>Ju faleminderit, jeni bashkëpunëtorët tonë më të rëndësishëm dhe presim gjithmonë vlerësimin ndaj shërbimit tonë dhe në faqen tonë zyrtare: www.dpshttr.gov.al</p>	E plote	0
16	16.02.2022	Kërkesë për informacion - Me kane hequr lejen e drejtimit dhe doja nje informacion se kur duhet te dal ne komision per provimin?	17.02.2022	<p>https://www.dpshttr.al/leje-drejtimi/rimarrja-e-lejes-se-drejtitimit</p>	E plote	0
17	23.02.2022	Denoncim për mos korrektësi në punë	23.02.2022	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor - DPSHTRR ka vendosur në dispozicion platformën si më poshtë ku ju mund të denonconi aktet abuzive apo korruptive nga punonjësit tanë.</p> <p>https://www.dpshttr.al/kontakti/zeri-yt-degjohet/denonco-akte-korruptive-apo-abuzive-nga-punonjesit-tane</p> <p>Dërgohen për verifikim vetëm rastet që kanë të dhëna vërtetuese për denoncimin dhe trajtojnë problematika në shërbimin e ofruar nga punonjësit tanë!</p> <p>Do të trajtohen me prioritet rastet kur shkelja denoncohet me foto ose video.</p> <p>Ju faleminderit,</p>	E plote	0

18	23.02.2022	Kërkesë për informacion	10.03.2022	<p>Ne vijim te kerkeses Tuaj te depozituar ne emailin zyrtar te Drejtorise se Pergjithshme te Sherbimeve te Transportit Rrugor (DPSHTRR) date 24.02.2022, te protokolluar me nr. 4984, date 25.02.2022, si dhe ne perputhje me nenin 11 te ligjit nr. 119/2014 "Per te drejten e Informimit", ju bejme me dije si me poshte vijon:</p> <p>Bazuar ne nenin 121 te ligjit nr. 8378, date 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikes se Shqiperise" i ndryshuar, autoshkollat ushtrojne veprimtarine si aktivitet i lire privat dhe licencimi i tyre behet sipas ligjit nr. 10 081, date 23.2.2009 "Per licencat, autorizimet dhe lejet ne Republiken e Shqiperise", te ndryshuar, duke respektuar kriteret teknike dhe profesionale.</p> <p>Mbikeqyrja administrative dhe teknike e veprimtarise se autoshkollave ushtrohet nga strukturat e DPSHTRR-se, ne baze te akteve te nxjerra nga ministria qe mbulon veprimtarine.</p> <p>Numri i subjekteve te regjistruara ne sistemin informatik te DPSHTRR-se deri me date 04.03.2022, qe ushtrojne veprimtarine autoshkolle ne Republiken e Shqiperise eshte 342.</p> <p>Ne subjektet qe ushtrojne veprimtarine autoshkolle per vitin 2019 jane ushtruar 270 kontrole, jane pezulluar 7 autoshkolla dhe jane mbyllur 6 autoshkolla; per vitin 2020 jane ushtruar 257 kontrole eshte pezulluar 1 autoshkolle dhe jane mbyllur 7 autoshkolla; per vitin 2021 jane ushtruar 287 kontrole, jane pezulluar 5 autoshkolla dhe jane mbyllur 16 autoshkolla.</p> <p>Testimet teorike dhe praktike kryhen ne perputhje me aktet ligjore dhe nenligjore ne fuqi, gjithashtu kandidati ka te drejten e ankimit te testit ne rast se argumenton se rezultati nuk eshte i drejte apo konstaton parregullsi te mundshme gjate procesit te testimit</p>	E plotë	0
19	23.02.2022	Kërkesë për informacion	24.02.2022	<p>Në përgjigje të e-mailit Tuaj, në zbatim të ligjit Nr. 119/2014 "Për të drejtën e Informimit" dhe ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", ju bëjmë me dije se ju nuk kemi bashkëlidhur asnjë dokumentacion ligjor që provon lidhjen Tuaj me kërkesën, për këtë arsye nuk mund t'ju ofrohet informacioni i kërkuar. Lutemi bashkëlidhni dokumentat përkatës për të vijuar me kërkesën(dokument identifikimi).</p> <p>Për më shumë informacion mund të na kontaktoni në numrin e telefonit zyrtar Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor - DPSHTRR, 0355 68 801 5833.</p> <p>Faleminderit për mirëkuptimin,</p>	E plotë	0